

Agjencia për Zhvillim
Rajonal • Qendër

| | |
|----------------------------|-------------------------------------|
| | REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KÖOVO |
| | KOMUNA E SHTIME-SHTIMLJE |
| Nr. / Përmbledhje / 02/21 | |
| Nr. i Fazave/Birrastra / 4 | |
| Data/Datum / 14.02.2025 | |
| SHTIME-SHTIMLJE | |



14/02/2025
02/1465

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
NDËRMJET
KOMUNËS SË SHTIMËS
DHE**

**AGJENCIA PER ZHVILLIM RAJONAL (AZHR) QENDËR
PËR REALIZIMIN E AKTIVITETEVE NE FUSHEN E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL**

DUKE PASUR PARASYSH se, Agjencia per Zhvillim Rajonal Qendër (më tutje referuar si "AZHR Qendër") është një organizatë jo qeveritare e themeluar sipas "Marrëveshja për bashkëpunim ndërmarrës komunal në Zonën Ekonomike- Qendër", të datës 16.12.2008 nga 8 Komunat e rajonit ekonomik Qendër (Prishtinë, Podujevë, Lipjan, Shtime, Drenas, Fushë Kosovë, Obiliq dhe Graçanicë, e regjistruar në Ministrinë e Administratës Publike me nr. të certifikatës 5112182-1 me certifikatë të numrit Fiskal 600281357 me adresë Sylejman Vokshi nr5 Prishtinë, Kosovë, me përfaqësues ligjor znj. Mimoza Tafarshiku, dhe përmision ka të udhëheq, lehtësoj dhe forcoj zhvillimin ekonomik lokal dhe rajonal si dhe ndërtimin e kapaciteteve, përkrahjes në implementimin e projekteve dhe kordinimin e aktivitetave dhe politikave zhvillimore në Komunat e rajonit ekonomik Qendër.

DUKE PASUR PARASYSH se. Komuna e Shtimes, e përcaktuar me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, (më tutje referuar si "Komuna e Shtimes"), është një nga themelueset e AZHR Qendër dhe është e angazhuar të ndërmarrë veprime që çojnë drejt zhvillimit ekonomik lokal të qëndrueshëm dhe për planifikim strategjik dhe pjesëmarrës, si dhe të planifikojë zbatimin, përmirësimin e dialogut publiko-privat, përgjegjshmërinë, llogaridhënen dhe bashkëpunimin ndërmarrës;

DERISA. AZHR Qendër dhe Komuna e Shtimes, duke u bazuar në Nenin 17, Pika S, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisjen Lokale; "Marrëveshja për bashkëpunim ndërmarrës komunal në Zonën Ekonomike- Qendër" Pika 8, 10 (paragrafi a dhe b) dhe 11 (paragrafi e); Statuti i AZHR Qendër Neni 3.1 dhe 3.2 (paragrafi e) kanë rënë dakord të intensifikojnë bashkëpunimin në disa fusha dhe aktivitete duke themeluar Ekipin Komunal për Projekte dhe ofruar Komunës së Shtimes asistencë teknike dhe profesionale në:

- Promovimin e zhvillimit ekonomik lokal;
- Asistencë në ofrimin e informacioneve relevante gjatë përgatitjes së Studimeve të Fizibilitetit për projekte zhvillimore;
- Mbështetje teknike gjatë përgatitjes së dokumenteve strategjike komunale;
- Mbështetje në përgatitjen e projekt propozimeve për aplikim në burime të ndryshme të financimit (donatorë vendor dhe ndërkombëtar);
- Mbështetje për tërheqjen e investimeve nga investitorë vendor dhe ndërkombëtar;
- Ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve komunal sipas nevojave me fokus përgatitjen dhe menaxhimin e projekteve të finançuara nga institucionet vendore dhe ndërkombëtare;
- Asistencë në organizimin dhe/ose bashkë-organizimin e aktivitetave promovuese për bizneset lokale etj

DERISA. AZHR Qendér dhe Komuna e Shtimës (më tutje referuar kolektivisht si "Palët" dhe individualisht si "Pala") njojin përfitimet e një bashkëpunimi të mirëfilltë, thelbësor dhe dëshirojnë të ndjekin një bashkëpunim të tillë (bashkë-implementimi i aktivitetave në fushën e zhvillimit ekonomik lokal në Komunën e Shtimës, hyjnë në këtë Marrëveshje të Bashkëpunimit (më tutje referuar si "MB") në një frymë besimi dhe bashkëpunimi;

Palët bien dakord si më poshtë:

NENI I

Fushëveprimi dhe Qëllimi

1. AZHR Qendér dhe Komuna e Shtimës lidhin këtë MB me qëllim të bashkëpunimit në fushën e zhvillimit socio-ekonomik lokal.
2. Rezultatet kryesore të bashkëpunimit do të janë si në vijim:
 - (a) Involvimi i Komunës së Shtimës në aktivitetet e përaktuara me këtë MB;
 - (b) Involvimi i AZHR Qendër në aktivitete me fokus zhvillimin ekonomik lokal të bazuar në praktika ndërkombëtare dhe në nevoja/kërkesa lokale me qëllim të zhvillimit të qëndrueshmëm lokal ekonomik;
 - (c) Përmirësimi i kapacitetave lokale dhe koordinimi i tyre për t'i adresuar sa më mirë sfidat në fushën e zhvillimit socio-ekonomik lokal;
 - (d) Zhvillimi dhe forcimi i kapacitetave lokale me qëllim tërheqjen e investimeve publike si dhe për të lehtësuar investimet e sektorit privat;

NENI II

Përgjegjësítë e Palëve

1. Në kuadër të këtij bashkëpunimi, secila prej palëve zotohet t'i zbatoj përgjegjësítë e mëposhtme me qëllim të realizimit sa më të mirë dhe efikas të qëllimit të këtij bashkëpunimi.
2. Komuna e Shtimës do të:
 - 2.1 Do të krijoj kushte pune për konsulentët e angazhuar duke përfshirë edhe pajisje të teknologjisë informative
 - 2.2 Drejtoretë relevante do të bashkëpunojnë ngushtë me anëtarët e Ekipit Komunal për Projekte duke ju ofruar atyre të dhëna dhe informata relevante lidhur me fushëveprimin dhe qëllimet e kësaj MB;
3. AZHR Qendér do të:
 - 3.1 Mbështet Komunën e Shtimës ekspertizë për t'i ndërtuar kapacitetet e nevojshme për zhvillimin e koncept projekteve investuese prioritare për komunën dhe për t'iu qasur investitorëve potencial vendor dhe të huaj;
 - 3.2 AZHR Qendér do të ofrojë trajnim cilësor për Ekipin Komunal për Projekte në zhvillimin e projekteve dhe qasja në kornizën logjike sipas standardeve të BE;
 - 3.3 Bashkëpunon me Komunën e Shtimës në implementimin e aktivitetave sipas kësaj MB;

NENI III

Procedurat e Kompenzimit

NENI III

Buxheti dhe Procedurat e Kompenzimit

Buxheti i paraparë për realizimin e kësaj MB është si në vijim:

| Buxheti | Shuma € | % |
|--|-------------|------|
| 1. Angazhimi i konsulentëve të rinj në kuadër të Ekipit Komunal për Projekte | 13,500.00 € | 90% |
| 2. Shpenzimet operative dhe menaxhuese | 1,350.00 € | 10% |
| Totali: | 14,850.00 € | 100% |

Në Ekipin Komunal për Projekte do të angazhohen 5 konsulentë të rinj për periudhë 6 mujore dhe me kompenzim mujor prej 450 € bruto.

Mënyra e pagesës:

Komuna e Shtimes do të transferoj në llogarinë e AZHR Qendër pagesën në shumën prej 14,850.00€.

Emri i përfituesit:

AGJENCIA PER ZHVILLIM RAJONAL QENDER

Numri i llogarisë bankare

1110299332010149 PCB

AZHR Qendër do të zbatoj projektin në përputhje me rregullat dhe rregulloret aktuale të Republikës së Kosovës si dhe do të aplikoj qasje transparente dhe do ta informoj Komunën e Shtimes në vazhdimësi.

NENI IV

Kordinimi dhe Konsultimet

Palët pajtohen që gjatë implementimit të kësaj MB, do të shkëmbejnë informacione dhe do të takohen rregullisht për të vlerësuar efektivitetin e mbëshjetjes nga AZHR Qendër si dhe dinamikat e implementimit të kësaj marrëveshjeje.

NENI V

Provizonet e përgjithshme

1. Amandamentimi apo shkëputja e Marrëveshjes.
- 1.1 Palët kanë të drejtë të shkëpusin pjesëmarrjen në Marrëveshje duke dërguar paralajmërim me shkrim së paku 30 ditë më herët,
2. Data e hyrjes në fuqi dhe kohëzgjatja.

2.1 Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga të dyja palët me kohëzgjatje prej 6 muajve dhe me mundësi vazhdimi.

3. Përlaqësimi.

3.1 Palët do të përlaqësohen nga persona të mandatuar nga nënshkruesit e marrëveshjes.

NENI VI

Pëlqimi i palëve

1. Palët duhet të veprojnë në besueshmëri të plotë për të siguruar arritjen e të gjitha objektivave të Marrëveshjes.
2. Mospajtimet ose interpretimet eventuale të ndryshme të pikave të kësaj marrëveshje do të rregullohen në mënyrë miqësore, me marrëveshje koncesuale.



NENI VII

Konflikti i Interesit

1. Palët garantojnë se në kohën e nënshkrimit të kësaj marrëveshje nuk ekziston ndonjë konflikt interesit ose ka të ngjarë të lindë gjatë zbatimit të kësaj MB.

2. Nëse lindë ndonjë konflikt interesit ose ka të ngjarë të shfaqet gjatë kohëzgjatjes së kësaj MB, palët duhet të:

- (a) Të njoftojnë njëri-tjetrin menjëherë;
- (b) Të bëjnë njoftimin e të gjitha informacioneve përkatëse në lidhje me konflikthin

| | |
|--|---|
| Për AZHR Qendër Znj. Mimoza Tafarshiku  Drejtoreshë ekzekutive AZHR Qendër Data: <u>14/02/2025</u> | Për Komunën e Shtimës AT-Ormeri Aliu  Kryetar i Komunës së Shtimës Data: <u>14.02.2025</u> |
|--|---|

